



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2023:133953

Datë: 05.11.2024

Numri i dokumentit: 06404400

C.nr.1036/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit Sh. D. nga fshati . . .Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 865.19 euro, jashtë seancës, më 05 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. D. nga fshati . . .Komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit së lartcekur, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga 01.05.2020 e deri me datën 21.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 865.19 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 11.05.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 228.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 11.05.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën

e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura në Shkollën “Ukshin Miftari” në fshatin . . .Komuna e Gjakovës. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësit. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësi ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar që të i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 05.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditësit nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi që në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e themeltë dhe si e tillë u aprovua në tërësi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në Shkollën “Ukshin Miftari” në fshatin . . .Komuna e Gjakovës. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është shuma prej 495.30 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2020 ka qenë 0.20%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen në vitin 2020 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës së paditësit) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën maj-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2020 ishte 495.30 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 8 mujore në total të jetë 7.92 euro, apo 0.99 euro për muaj ( $495.30 * 0.20\% * 8 = 7.92$ ).
- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte ishte 496.29 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 202.49 euro, apo 16.87 euro për muaj ( $496.29 * 3.4\% * 12 = 202.49$ ).

- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 513.16 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 654.80 euro, apo 59.53 euro për muaj ( $513.16 * 11.6% * 11 = 654.80$ ).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.05.2020 e deri me datën 21.11.2022 në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësin.

Pretendimin tjetër të të paditurës lidhur me atë se inflacioni godet tërë aparatit shtetëror e jo vetëm sektorin e arsimit, gjykata e konsideron si të parëndësishëm, për arsye se çështja e përfshirjes së inflacionit në pagën e punëtorëve të arsimit është e rregulluar me KKAK, andaj është irelevantë se kushte goditet nga inflacioni, për aq kohë sa e drejta e paditësit për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se kërkesa është e parashkruar në tërësi është i pabazuar, pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 11.05.2023 rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre (3) viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro si dhe për parashtrësën e datës 23.09.2024 shumen prej 104.00 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1036/23, më 05 nëntor 2024

Gj y q t a r j a

Blerina KURTAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.